

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 01/07, lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave preventive në Komunën e Vushtrrisë, si dhe bazuar në informatat zyrtare për infektim me koronavirus COVID – 19 të dy punëtorëve në marketin “Emona në Vushtri, Shtabi Emergjent, në mbledhjen e mbajtur më 01.04.2020, merr këtë:


V E N D I M

1. Drejtoria për Inspektime – inspektorati kompetent i kësaj drejtorie menjëherë të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme të mbikëqyrjes në Marketin “Emona Center” në Vushtri, nëse i ka zbatuar masat mbrojtëse të punëtorëve (maska, dorëza, dezinfektues) të cilët punojnë dhe të cilët mund të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me konsumatorë.
2. Të bëhet kontrollimi i hapësirave të Emona Center nëse është bërë dezinfektimi i atyre hapësirave, si dhe masave tjera mbrojtëse tashmë të njohura dhe të kërkuara nga IKSHIP-së.
3. I rekomandohet Personelit udhëheqës të marketit “Emona Center” në Vushtri që të dërgoj në vet izolim të gjithë punëtorët pasi që vlerësohet se kanë qenë në kontakt me dy punëtorët të cilat tani më është konstatuar se janë prekur nga koronavirusi COVID-19 për të iu shmangur mundësisë së përhapjes së kësaj sëmundje. Në vetë izolim duhet të dërgohen punëtorët që kanë punuar nga data 25.03.2020 për periudhë 14 ditore sipas rekomandimeve të IKSHIP duke llogaritur vet izolimin nga data 25.03.2020. Punëtorët në vetizolim nuk duhet të humbin vendin e punës për shkak të kësaj mase. Të dhënat dhe kontaktet e këtyre punëtorëve duhet të dorëzohen nga “Emona Center” në Shtab Emergjent Komunal dhe IKSHIP menjëherë me datë 01.04.2020.
4. Apelojmë të gjithë qytetarët e komunës të rrinë në shtëpi, të iu shmangen sa më shumë që të jetë e mundur daljes nga shtëpitë e tyre sepse vetëm kështu parandalojmë përhapjen e Coronavirus, ruajmë vetën, familjen dhe qytetin tonë.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 01/11, lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave preventive në Komunën e Vushtrisë, si dhe bazuar në informatat zyrtare për infektim me koronavirus COVID – 19 të dy qytetarëve në fshatin Smrekonicë për edhe mundësisë së përhapjes edhe në vendet tjera në Komunën e Vushtrisë, Shtabi Emergjent komunal, në mbledhjen e mbajtur më 06.04.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. I rekomandohet personelit udhëheqës të marketeve në Vushtri, që të ndërmarrin masat e duhura të kufizimit të hyrjeve të klientëve në marketet e tyre – të mos lejojnë që të hyjnë më shumë se 15 qytetarë përnjëherë dhe vet të kujdesen që konsumatrët brenda të ruajnë distancën.
2. Masa e kufizimeve të hyrjes së qytetarëve në numër më të madh, nga i cili krijohet mundësia e infektimit me COVID -19 përmes kontakteve, do të vlejë edhe për dyqanet e bizneset tjera shërbyese në territorin e komunës.
3. Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi do ta bëj Drejtoria e Inspektimeve – Inspektorati kompetent në bazë të legjislacionit në fuqi, e cila do të i njoftoj me shkrim subjektet e cekura më lartë lidhur me masat të cilat janë parapa të ndërmerren në bazë të këtij vendimi.
4. Apelojmë të gjithë qytetarët e komunës të rrinë në shtëpi, të iu shmangen sa më shumë që të jetë e mundur daljeve nga shtëpitë e tyre sepse vetëm kështu parandalojmë përhapjen e Coronavirus, ruajmë vetën, familjen dhe qytetin tonë.




Xhafer Fahiri

Kryetar i Komunës –
Kryesues i Shtabit Emergjent

Dërgohet:

- Drejtorisë për Inspektime
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 01/11, lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave preventive në Komunën e Vushtrrisë, Kryetari i Komunës me datën 08.04.2020, merr këtë:

V E N D I M


1. Obligohen nëpunësit civil në administratën e komunës që me rastin e ofrimit të shërbimeve komunale ndaj palëve të jenë të pajisur me maska mbrojtëse dhe dorëza.
2. Obligohen bizneset e komunës që t'i pajisin punëtorët e tyre me maska dhe dorëza. Inspektorati i komunës do ti mbyllë dhe shqiptoj gjoba konform legjislacionit në fuqi, të gjitha bizneseve në të cilat gjen se punëtorët e tyre janë të pa mbrojtur me pajisje personale (maska dhe dorëza).
3. Obligohen marketet në komunën e Vushtrrisë që të bëjnë dezinfektimin e karrocave të të gjitha llojeve pas çdo përdorimi (të caktoj punëtorin që do të merret me këtë punë).
4. Asnjë biznes nuk do të i ofroj shërbim (shitje të mallit) asnjë konsumatori i cili hyn në lokalit e biznesit pa maskë dhe dorëza. Në raste të tilla Inspektorati i komunës do të mbyllë dhe shqiptoj gjoba konform legjislacionit në fuqi çdo biznesi në të cilin gjenden konsumatorë që janë të pa mbrojtur me pajisje personale mbrojtëse (maska dhe dorëza). Po ashtu gjoba do të iu shqiptohen konform rregullativës ligjore edhe konsumatorëve që hyjnë pa mjete mbrojtëse personale (maska dhe dorëza).
5. Apelojmë tek të gjithë qytetarët që të rrinë në shtëpi, ta ruajnë distancën kudo, ndërsa kur do të kenë nevojë për të dalë jashtë shtëpisë, të bartin maska dhe dorëza.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Inspektime
- Arkivit të Sekretarisë



Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 01/11, lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave për mbrojtje nga përhapja e korona virusit COVID-19 në territorin e Komunës së Vushtrrisë, si dhe tejkalimit me sa më pak pasoja të kësaj gjendje, Kryetari i Komunës – Kryesues i Shtabit Komunal për Emergjencë, me datën 10.04.2020 merr këtë:


V E N D I M

1. Të gjitha Këshillat e Fshatrave në Komunën e Vushtrrisë marrin kompetenca detyra dhe përgjegjësi të Shtabeve Lokale për Emergjencë, për parandalim të përhapjes së pandemisë me COVID-19.
2. Shtabet Lokale për Emergjencë do të përcjellin në vazhdimësi gjendjen në terren në vendbanimet e tyre përta i përket të dhënave për mundësinë e infektimeve të banorëve përmes kontakteve në mes tyre dhe informojnë te shtabi komunal i emergjencës, monitoroj gjendjen sociale dhe materiale të familjeve sociale dhe të atyre që kanë punuar ndërsa tani kanë mbete pa punë për shkak të pandemisë me koronaavirus për të i ndihmuar ato familje me ndihma në pako ushqimore dhe higjienike, bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës dhe ninstitucionet tjera relevante komunale, si dhe do të kryejnë edhe aktivitete tjera të domosdoshme në bashkërendim me Shtabin Komunal për Emergjencë në Vushtrri.
3. Shtabet Lokale për Emergjencë duhet të jenë në kontakt të vazhdueshëm me shtabin komunal të komunës dhe raportojnë në baza të rregullta kur një gjë e tillë do të jetë e nevojshme. Kontakti: shkelzen.xhaferi@rks-gov.net, Tel. dhe viber: 045 111 399.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe iu komunikohet menjëherë kryetarëve të këshillave të fshatrave – shtabeve lokale emergjente.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës –
Kryesues i Shtabit Komunal
Emergjent



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 01/11, lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave për mbrojtje nga përhapja e korona virusit COVID-19 në territorin e Komunës së Vushtrrisë, Kryetari i Komunës – Kryesues i Shtabit Komunal për Emergjencë, me datën 14.04.2020 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i shtabit komunal të emergjencës për mbrojtje nga koronavirusi për vendosje të dy tuneleve dezinfektuese në qendër të qytetit në të cilët do të mund të bëhej dezinfektimi i qytetarëve – kalimtar të rastit. Qëllimi i vendosjes së tyre është që të shërbejnë si masë preventive nga rreziku i infektimit të qytetarëve me COVID-19.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Prokurim Publik.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës –
Kryesues i Shtabit Komunal
Emergjent

Dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Prokurim Publik
- Arkivit të Sekretarisë

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRIN
02 Nr. / Br. 338-1/20
Nr. i fq. / Br. sh. _____
Dستا: / Datum 14.04.2020
VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, nenin 67 shkronja "g" të Statutit të Komunës, vendimin e KK-së 01nr. 65/20 dt. 26.03.2020 si dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave parandaluese për mbrojtje nga virusi COVID-19, Kryetari i Komunës – Kryesues i Shtabit Komunal të Emergjencës merr këtë:

V E N D I M

1. Për shkak të situatës emergjente nga rreziku i përhapjes së infeksionit me koronavirus në Vushtri dhe me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve përkatësisht parandalimit të përhapjes së kësaj sëmundje, lejohet furnizimi dhe instalimi i dy portave dezinfektuese në procedurë të modulit të aprovimit, me çmim të tregut.
2. Portat dezinfektuese duhet të vendosen: njëra në sheshin "Hasan Prishtina" përball ndërtesës së komunës dhe tjetra para objektit të QMF-së në Vushtri në Rr. "Dëshmorët e Kombit".
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa do të kryej pagesën e faturës pas pranimit të raportit të komisionit për pranim të mallit – furnizimit dhe instalimit të portave dezinfektuese.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Prokurim Publik
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të sekretarisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRIN

03 Nr. / Nr. 340/20

Nr. Liq. / Bl. si

Data: / Datum 15.04.2020

VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 dhe 17 shkronja "g" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 54 paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenin 67 shkronja "f" dhe "g" të Statutit të Komunës kërkesës së MAPL, dt. 13.04.2020 dhe në kërkesë të Drejtorit për Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryetari i Komunës me datën 14.04.2020 merr këtë:

V E N D I M


1. Aktivizohet Qendra Operative Emergjente Lokale me rastin e shfaqjes së virusit COVID – 19 në Komunën e Vushtrrisë.
2. Qendra Operative Emergjente Lokale është në shërbim 24/h.
3. Numrat e kontaktit dhe e-maili; **0800 42000 (pa pagesë) dhe 038/ 20042421 (me pagesë)**
E-maili: shtabi.vushtrri@rks-gov.net
4. Qendra Operative Emergjente Lokale i raporton Kryetarit të Komunës dhe Qendrës Operative Regjionale përkatësisht Qendrës Operative të Agjencisë.
5. Qendra Operative Lokale është në funksion deri në marrjen e një vendimi tjetër.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës



Dërgohet:

- Qendrës Operative
- Zyrës për Informim
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, nenin 67 shkronja "f" dhe "g" të Statutit të Komunës dhe vendimin e KK-së 01nr. 65/20 dt. 26.03.2020, Kryetari i Komunës – Kryesues i Shtabit Komunal të Emergjencës për mbrojtje nga virusi COVID-19 merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR PRANIM TË MALLIT

1. Formohet komisioni për pranim të mallit – dy portave dezinfektuese për qytetarë të Komunës së Vushtrrisë me qëllim të shmangies nga rreziku i infektimit me korona virus, në këtë përbërje:
 - 1.1 Rrahim Ajeti, kryesues i komisionit
 - 1.2 Refik Maloku, anëtar
 - 1.3 Bajrush Kosumi, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të vërtetoj nëse është sjellë malli – dy porta dezinfektuese dhe është bërë instalimi i tyre, njëra në sheshin "Hasan Prishtina" përball ndërtesës së komunës dhe tjetra para objektit të QMF-së në Vushtri në Rr. "Dëshmorët e Kombit".
3. Komisioni për punën e tij do të paraqes raport në drejtorinë e prokurimit publik dhe drejtorinë për buxhet dhe financa me qëllim të kryerjes së pagesës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të sekretarisë

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRIN

02 Nr./Dr. 349/20

Nr. Hq./Dr. sh.

Data: / Datum 16.04.2020

VUSHTRRI - VUCITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 dhe 17 shkronja "g" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 54 paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenin 67 shkronja "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, kërkesës së MAPL, dt. 13.04.2020 dhe vendimi 02nr. 340/20, datë 15.04.2020, Kryetari i Komunës me datën 16.04.2020 merr këtë:

V E N D I M

1. Në përbërje të Qendrës Operative Lokale Emergjente për parandalim të përhapjes së virusit COVID – 19 në Komunën e Vushtrrisë caktohen:
 - 1.1 Bajrush Kosumi, menaxher i QOLE
 - 1.2 Behram Rrahmani, zyrtar i komunës
 - 1.3 Bajram Beqiri, Zyrtar i komunës
 - 1.4 Sami Ibishi, zyrtar i komunës
 - 1.5 Abaz shyti, zyrtar i komunës
2. Stafi i Qendrës Operative Emergjente Lokale të cekur në pikën paraprake do të kujdesen që qendra të jetë në shërbim 24/h.
3. Z. Bajrush Kosumi menaxher i qendrës autorizohet që në emër të Shtabit komunal për Emergjencë dhe Qendrës operative lokale të i nënshkruaj të gjitha kërkesat për leje të lëvizjes së lirë për qytetarët e komunës së Vushtrrisë.
4. Qendra Operative Emergjente Lokale i raporton Kryetarit të Komunës dhe Qendrës Operative Regjionale përkatësisht Qendrës Operative të Agjencisë.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës numër 0015095 datë 06.03.2020, në shumë prej 74.80 € (shtatëdhjetëkatër euro e tetëdhjetë cent), me rastin e shpenzimeve të krijuara nga Kryetari i Komunës në "DPH "Prestige" në vushtrri (pije freskuese) me mysafir me rastin e shënimit të "Epopesë së UÇK-së".
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.